



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes propozon:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit për Zonat Ekonomike, nenit 11 të Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike, nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_ 2022, të miratojë këtë :

#### PROPOZIM

#### **VENDIM**

#### **PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE TË SUBJEKTEVE AFARISTE NË ZONËN EKONOMIKE "PARKU INDUSTRIAL" NË QYLAGË**

#### **Neni 1**

#### **Përbërja e Komisionit**

Formohet Komisioni i ankesave për shqyrtimin e ankesave të subjekteve afariste në zonën ekonomike "Parku industrial" në Qylagë ( në vazhdim të tekstit: Komisioni në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve:

1. \_\_\_\_\_ nga ekzekutivi i komunës, kryesues
2. \_\_\_\_\_ nga ekzekutivi i komunës, anëtar
3. \_\_\_\_\_ nga kuvendi i komunës, anëtar
4. \_\_\_\_\_ nga kuvendi i komunës, anëtar
5. \_\_\_\_\_ nga shoqëria civile, anëtar

#### **Neni 2**

#### **Mandati i anëtarëve**

Mandati i anëtarëve të Komisionit është i lidhur me mandatin e Kuvendit të Komunës.

**Neni 3**  
**Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit**

Komisioni ka për detyrë dhe përgjegjësi të bëjë shqyrtimin e ankesave të cilat do të parashtrohen nga subjektet afariste ofertat e të cilëve janë refuzuar nga Komisioni vlerësues për t'u vendosur në Zonën Ekonomike "Parku Industrial " në Qyragë brenda afatit 30 (tridhjetë) ditor.

Komisioni i ankesave kryen punët dhe detyrat në pajtim me me dispozitat e Ligjit për Zonat Ekonomike dhe Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike , kriterëve të përcaktuara në konkursin publik si dhe dispozitave tjera ligjore përkatëse.

**Neni 5**  
**Punët administrative - juridike të Komisionit**

Komisionit në realizimin e detyrave të përcaktuara me Ligj me akte nënligjore dhe me këtë vendim do ti ndihmojnë në kuadër të kompetencave të tyre Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

**Neni 6**  
**Kompenzimi i punës së Komisionit**

Anëtarët e Komisionit për punën e tyre për zbatimin e procedurave të vlerësimit të ofertave të një Konkursi publik do të kompenzohen në lartësinë e një kompenzimi, i cili u paguhet për pjesëmarrje në mbledhje anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa. Kompenzimi do të bëhet vetëm për anëtarët e komisionit të cilët nuk e kanë të ndaluar kompenzimin për kryerjen e shërbimeve shtesë konform dispozitave të Ligjit për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe akteve tjera nënligjore me të cilat rregullohet kjo çështje nëse të njëjtat nuk bien në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

**Neni 7**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës

## Arsyetim

### Baza juridike

Baza juridike për të propozuar Vendimin është e përcaktuar me dispozitat e nenit 58 shkronja h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 40 shkronja h.) e Statutit të Komunës së Lipjanit.

Baza juridike dhe obligimi ligjor për të miratuar këtë Vendim është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Zonat Ekonomike , nenit 11 të Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike.

Komisioni ka për detyrë dhe përgjegjësi të bëjë shqyrtimin e ankesave të cilat do të parashtrihen nga subjektet afariste ofertat e të cilëve janë refuzuar nga Komisioni vlerësues për t'u vendosur në Zonën Ekonomike "Parku Industrial " në Qylagë brenda afatit 30 ditor.

Komisioni i ankesave kryen punët dhe detyrat në pajtim me me dispozitat e Ligjit për Zonat Ekonomike dhe Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike , kriterëve të përcaktuara në konkursin publik si dhe dispozitave tjera ligjore përkatëse.

Nga të cekurat më lartë, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 011/01-25395  
Lipjan, 18. 05. 2022

